

RREGULLORE E BRENDSHME PËR FUNKSIONIMIN

E KËSHILLIT TË STATISTIKAVE

(Miratuar në mbledhjen e Këshillit të Statistikave, datë 31/10/ 2019)

Përmbajtje	
I – DISPOZITA TË PËRGJITHSHME	2
Neni 1 - Qëllimi	2
Neni 2 - Baza Ligjore.....	3
Neni 3 - Përkufizime	3
II - STRUKTURA	4
Neni 4 - Përbërja	4
Neni 5 - Roli dhe detyrat e Këshillit të Statistikave.....	4
Neni 6 - Lirimi dhe largimi nga detyra e anëtarëve të KS	5
III - ORGANIZIMI	5
Neni 7 - Mbledhjet e Këshillit të Statistikave.....	5
Neni 8 - Zgjedhja e kryetarit të Këshillit	7
Neni 9 - Zgjedhja e zëvendëskryetarit të Këshillit.....	7
Neni 10 - Sekretariati i Këshillit të Statistikave.....	8
Neni 11 - Materialet e mbledhjes dhe mënyra e paraqitjes së tyre për shqyrtim.....	8
Neni 12 - Procedura e marrjes së vendimeve dhe e votimit në mbledhjet e Këshillit	9
Neni 13 - Procesverbali i mbledhjes	9
Neni 14 - Zbardhja e vendimeve.....	10
Neni 15 - Angazhimi i ekspertëve të jashtëm për një fushë të caktuar të statistikave zyrtare dhe raporti i ekspertëve.....	10
IV - KOMUNIKIMI ZYRTAR	11
Neni 16 - Procedura e komunikimit me stafin e agjencive statistikore	11
Neni 17 - Format i shkresës	11
V - Konfidencialiteti dhe konflikti i interesave	12
Neni 18 - Konfidencialiteti dhe konflikti i interesave	12
VI - TË TJERA	12
Neni 19 - Dispozita të fundit.....	12
Shtojca 1.....	14
Shtojca 2.....	15
Shtojca 3.....	16

I – DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 - Qëllimi

Kjo rregullore ka për objekt rregullimin në mënyrë të detajuar të marrëdhënieve të anëtarëve të Këshillit të Statistikave, mënyrës së dokumentimit të mbledhjeve si dhe përcaktimin e komunikimit ndërmjet anëtarëve të Këshillit me administratën e INSTAT.

Neni 2 - Baza Ligjore

Këshilli i Statistikave e ushtron aktivitetin e tij në mbështetje të legjislacionit të mëposhtëm:

1. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
2. Ligji nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative”;
3. Ligji nr. 17/2018 "Për Statistikat Zyrtare";
4. Ligji nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar;
5. Ligji nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”;
6. VKM nr. 670, datë 07.11.2018 "Për kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes, të përfaqësimit, emërimit e shkarkimit, rregullat e funksionimit dhe masën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit të Statistikave";
7. Vendimet përkatëse të Kuvendit për emërimin/lirimin e anëtarëve dhe kryetarit të Këshillit të Statistikave;

si dhe akte të tjera ligjore e nënligjore në fuqi të cilat rregullojnë procesin e prodhimit të statistikave zyrtare.

Neni 3 - Përkufizime

1. “Këshilli” nënkupton Këshillin e Statistikave;
2. “Kryetari” nënkupton kryetarin e Këshillit të Statistikave;
3. “Sekretariati” nënkupton personat e caktuar të mbulojnë detyrën e Sekretariatit të Këshillit të Statistikave;
4. “Anëtar” nënkupton anëtarët e Këshillit të Statistikave;
5. “Ligji i statistikave” nënkupton Ligjin 17/2018 "Për statistikat zyrtare";
6. “Programi” nënkupton Programin e Statistikave Zyrtare pesëvjeçar të miratuar me vendim të Kuvendit të Shqipërisë;
7. “Ligji për organet kolegjiale” nënkupton ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”;
8. “VKM” nënkupton VKM nr. 670 datë 07.11.2018 "Për kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes, të përfaqësimit, emërimit e shkarkimit, rregullat e funksionimit dhe masën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit të Statistikave".

II - STRUKTURA

Neni 4 - Përbërja

1. Këshilli i Statistikave është organ këshillimor, i përbërë nga ekspertë, përfaqësues të institucioneve dhe organizatave përdoruese të statistikave zyrtare.
2. Këshilli i Statistikave përbëhet nga:
 - a) një përfaqësues i organeve të vetëqeverisjes vendore;
 - b) një përfaqësues i Bankës së Shqipërisë;
 - c) një përfaqësues i ministrisë përgjegjëse për financën;
 - d) dy përfaqësues të përdoruesve kryesorë të statistikave zyrtare;
 - e) dy përfaqësues të botës akademike;
 - f) një përfaqësues i shoqërisë civile;
 - g) një përfaqësues i Bashkimit të Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë së Shqipërisë;
 - h) një përfaqësues i medias;
 - i) Drejtori i Përgjithshëm i INSTAT-it.

Neni 5 - Roli dhe detyrat e Këshillit të Statistikave

1. Këshilli i Statistikave monitoron veprimtarinë e INSTAT dhe agjencive statistikore për përmbushjen e detyrave të parashikuara në Programin pesëvjeçar të Statistikave zyrtare.
2. Këshilli i Statistikave ka këto detyra:
 - a) jep mendim për projektprogramin, ndryshimet e tij dhe nëpërmjet Drejtorit të Përgjithshëm i njoftohet Këshillit të Ministrave për dërgimin e tij për miratim Kuvendit;
 - b) jep mendim për planin vjetor të INSTAT-it për zbatimin e programit;
 - c) vlerëson raportin vjetor të Drejtorit të Përgjithshëm për zbatimin e programit dhe ecurinë e Sistemit Kombëtar Statistikor;
 - d) shqyrton raportet e shkurtra katërmujore të ecurisë në zbatimin e programit, të paraqitura nga Drejtori i Përgjithshëm;
 - e) vlerëson zbatimin e parimeve statistikore nga institucionet, sipas përcaktimeve në nenet 4 dhe 5 të ligjit të statistikave;
 - f) miraton rregulloren e brendshme për funksionimin e tij;
 - g) diskuton drejtpërdrejt me drejtuesit e strukturave, që merren me statistikat në ministri dhe agjencitë e tjera statistikore për çështje që kërkojnë mbështetjen ose veprimin e agjencive, për të siguruar që çdo statistikë zyrtare të përmbushë standardet profesionale;

- h) përgatit raporte që kërkojnë vendimin e këtij këshilli për të siguruar që çdo statistikë zyrtare të përmbushë standardet profesionale;
 - i) kërkon vlerësim, llogaritje ose kontroll të pavarur nga ekspertë të jashtëm për një fushë të caktuar të statistikave zyrtare. Kostoja për këto veprimtari do të mbulohet nga buxheti i INSTAT-it.
3. Këshilli i Statistikave e ushtron funksionin e tij duke u mbështetur në kapacitetet profesionale të anëtarëve, njohuritë mbi metodat statistikore, si përdorues të statistikave zyrtare.

Neni 6 - Lirimi dhe largimi nga detyra e anëtarëve të KS

1. Anëtarët e Këshillit të Statistikave caktohen për një mandat pesëvjeçar, duke synuar që datat e mbarimit të këtij afati për çdo anëtar të jenë të shpërndara gjatë periudhës pesëvjeçare. Anëtarët kanë të drejtë rrimërimi jo më shumë se një herë.
2. Anëtarët e Këshillit të Statistikave mund të shkarkohen nga Kuvendi kur kryejnë një ose disa nga shkeljet e mëposhtme:
 - a) mungojnë më shumë se tri herë dhe në mënyrë të përsëritur në mbledhje;
 - b) ndeshin konflikte interesi me interesat e INSTAT-it dhe/ose agjencive të tjera statistikore;
 - c) për shkaqe sëmundjesh fizike ose mendore, gjë që i bën të paaftë për të kryer funksionet e ngarkuara;
 - d) kur dënohen nga gjykata me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;
 - e) kur lirohen nga pozicioni dhe nuk mund të përfaqësojnë më institucionin në këshill.
3. Propozimi i shkarkimit të tyre kryhet nga institucioni që ka të drejtën e propozimit të emërimit, sipas përkatësisë.

III - ORGANIZIMI

Neni 7 - Mbledhjet e Këshillit të Statistikave

1. Këshilli i Statistikave thërret mbledhjen e parë brenda 1 (një) muaji nga konstituimi i mandateve të anëtarëve të tij.
2. Këshilli i Statistikave mblidhet të paktën 3 (tre) herë në një vit kalendarik. Këshilli i Statistikave mund të mblidhet edhe më shpesh në varësi të çështjeve që kërkojnë të shqyrtohen për sigurimin e mbarëvajtjes së Sistemit Kombëtar Statistikor.

3. Mbledhja e Këshillit të Statistikave quhet e vlefshme kur në të marrin pjesë të paktën 7 (shtatë) anëtarë të tij. Në rastet kur nuk plotësohet kuorumi, Kryetari shtyn mbledhjen në një datë tjetër, të paktën 48 orë pas së parës.
4. Mbledhja thirret nga kryetari i Këshillit të Statistikave. Në mungesë të tij mbledhja thirret nga zëvendëskryetari dhe, në mungesë të këtij të fundit, nga anëtari më i vjetër në detyrë.
5. Kryetari është i detyruar të thërrasë mbledhjen kur atë e kërkon me shkrim të paktën 1/3 e anëtarëve të Këshillit të Statistikave ose Drejtori i Përgjithshëm i INSTAT-it. Në këto raste, mbledhja organizohet jo më vonë se 15 ditë pas kërkesës së paraqitur prej tyre.
6. Kur kryetari i Këshillit të Statistikave lirohet apo shkarkohet nga detyra për një shkaqet e parashikuara në ligjin për statistikën zyrtare, mbledhja e radhës thirret nga Drejtori i Përgjithshëm i INSTAT, pasi të jetë emëruar anëtari zëvendësues.
7. Kërkesa për thirrjen e mbledhjes duhet të përmbajë arsyen e thirrjes së saj dhe rendin e ditës.
8. Kryetari vendos për datën, kohën e mbledhjeve të radhës dhe njofton anëtarët e Këshillit të paktën 5 ditë pune përpara mbledhjes. Rendi i ditës u njoftohet anëtarëve jo më vonë se 2 ditë pune para organizimit të mbledhjes.
9. Si rregull, mbledhja e Këshillit zhvillohet në ambientet e INSTAT, me përjashtim të rastit kur kryetari vendos ndryshe.
10. Mbledhja e Këshillit thirret duke komunikuar kohën, vendin dhe rendin e ditës së mbledhjes. Lajmërimi për mbledhje shoqërohet së bashku me materialet për shqyrtim për të gjithë anëtarët e Këshillit.
11. Lajmërimi i mbledhjes dërgohet nga Sekretariati në formë shkresore dhe elektronike në adresat zyrtare të anëtarëve të Këshillit, të depozituara paraprakisht në sekretariat.
12. Data e lajmërimit të anëtarit do të konsiderohet data e dërgimit të lajmërimit në rrugë elektronike.
13. Si rregull, anëtari i Këshillit dërgon konfirmimin e marrjes së lajmërimit përkatës.

14. Mbledhja e Këshillit drejtohet nga kryetari. Në mungesë të kryetarit, mbledhja drejtohet nga zëvendëskryetari dhe në mungesë të këtij të fundit nga anëtari më i vjetër në detyrë.
15. Në fund të mbledhjes, kryetari deklaron mbylljen e saj. Nëse çështjet e rendit të ditës nuk arrijnë të shqyrtohen brenda ditës së mbledhjes, ai vendos vazhdimin e mbledhjes në një ditë tjetër ose përfshirjen e çështjeve në mbledhjen e ardhshme të Këshillit.
16. Drejtori i Përgjithshëm i INSTAT-it merr pjesë pa të drejtë vote, në mbledhjen e Këshillit që ka në rend dite çështje që përbëjnë konflikt interesi me të.

Neni 8 - Zgjedhja e kryetarit të Këshillit

1. Zgjedhja e kryetarit të Këshillit të Statistikave kryhet me votim të fshehtë të anëtarëve.
2. Kandidati për Kryetar duhet të jetë nga anëtarët që nuk janë përfaqësues të institucioneve publike.
3. Zgjedhja e kryetarit zhvillohet sipas procedurës së mëposhtme:
 - a) Sekretariati përgatit nga një fletë votimi për secilin anëtar të pranishëm në mbledhje.
 - b) Në fletën e votimit shkruhen emrat e anëtarëve që nuk përfaqësojnë institucionet publike.
 - c) Secili prej anëtarëve të Këshillit voton duke bërë shënimin me kryq, për një nga emrat që janë në fletëvotim. Një anëtar nuk mund të zgjedhë më shumë se një kandidat.
 - d) Kandidatura që ka marrë të paktën 7 vota zgjidhet kryetar i Këshillit të Statistikave.
 - e) Në rast se asnjë prej kandidatëve nuk ka marrë numrin e kërkuar të votave ose votat janë të barabarta, atëherë bëhet një raund i dytë votimi. Kandidatura që merr më shumë vota në raundin e dytë zgjidhet kryetar i Këshillit. Raundi i dytë dhe votimi zhvillohet brenda së njëjtës ditë.
 - f) Në rast se edhe në raundin e dytë kandidatët marrin vota të barabarta, atëherë vendos vota e Drejtorit të Përgjithshëm të INSTAT.
4. Kryetari zgjidhet deri në fund të mandatit.

Neni 9 - Zgjedhja e zëvendëskryetarit të Këshillit

1. Zëvendëskryetari i Këshilli zgjidhet sipas të njëjtës procedurë si ajo e zgjedhjes së kryetarit të Këshillit parashikuar në nenin 8 të rregullores.
2. Kandidati për zëvendëskryetar nuk duhet të jetë përfaqësues i institucioneve publike.

Neni 10 - Sekretariati i Këshillit të Statistikave

1. Shërbimi i sekretariatit sigurohet nga INSTAT-i sipas një urdhri të brendshëm të Drejtorit të Përgjithshëm të INSTAT për caktimin e personave që do të mbulojnë detyrën e sekretariatit.
2. Këshilli i Statistikave cakton një anëtar të tij me detyrën për mbikëqyrjen e punës së sekretariatit.
3. Sekretariati i Këshillit lehtëson organizimin e mbledhjeve dhe mban dokumentacionin përkatës të mbledhjeve.
4. Sekretariati mban procesverbalin përkatës të mbledhjes dhe e nënshkruan atë pasi të ketë marrë miratimin paraprak të të gjithë anëtarëve të Këshillit për të konfirmuar saktësinë e tij dhe zbardh të gjitha vendimet e Këshillit.

Neni 11 - Materialet e mbledhjes dhe mënyra e paraqitjes së tyre për shqyrtim

1. Materialet që paraqiten për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit depozitohen pranë sekretariatit nga strukturat përgjegjëse që janë marrë me përgatitjen e tyre. Sekretariati ia paraqet materialet Kryetarit jo më vonë se 8 ditë nga data e zhvillimit të mbledhjes.
2. Në rastet kur materialet e paraqitura konsiderohen si jo të plota nga Kryetari, atëherë Sekretariati ia rikthen për shqyrtim strukturave përgjegjëse të cilat e kanë përgatitur atë.
3. Strukturat përgjegjëse shqyrtojnë materialet dhe ia ridërgojnë Sekretariatit brenda 3 (tre) ditëve nga rikthimi i tyre.
4. Materialet që paraqiten në mbledhjen e Këshillit duhet të jenë të nënshkuara nga nëpunësit e strukturës përgjegjëse për hartimin e tyre.

Neni 12 - Procedura e marrjes së vendimeve dhe e votimit në mbledhjet e Këshillit

1. Vendimet e Këshillit të Statistikave janë të vlefshme në rast se ato miratohen nga të paktën 7 (shtatë) anëtarët e tij dhe zbardhen brenda 3 (tre) ditëve nga data e mbledhjes.
2. Vendimet e Këshillit të Statistikave merren me votim të hapur të të gjithë anëtarëve të pranishëm në mbledhje.
3. Në rastet kur Këshilli shqyrton sjelljen apo cilësitë e një individi, vendimi merret me votim të fshehtë.
4. Secili anëtar i Këshillit ka të drejtën e një vote.
5. Kryetari voton i fundit.
6. Në votim nuk lejohet abstenimi. Vota kundër argumentohet dhe pasqyrohet në procesverbal.
7. Në rastin kur rezultati i votimit është i barabartë dhe votimi nuk ka qenë i fshehtë, atëherë vota e kryetarit është vendimtare.
8. Në rastin kur rezultati i votimit është i barabartë dhe votimi ka qenë i fshehtë, atëherë votimi kryhet edhe një herë. Në rast se votimi rezulton përsëri i barabartë, atëherë votimi shtyhet për mbledhjen tjetër. Në rast se votimi do të jetë përsëri i barabartë, atëherë votimi kryhet i hapur.
9. Në rastet kur ndaj materialit të paraqitur bëhen vërejtje, atëherë ai votohet në parim dhe, nëse votohet pro miratimit të tij, atëherë kalohet në votimin e çdo propozimi të bërë nga secili anëtar dhe, në fund, vendoset për materialin me ndryshimet e bëra në mbledhje. Në të kundërt, materiali nuk miratohet.

Neni 13 - Procesverbali i mbledhjes

1. Në çdo mbledhje të Këshillit mbahet një procesverbal i cili përmban një përmbledhje të diskutimeve të zhvilluara, data dhe vendi i mbledhjes, anëtarët që morën pjesë, çështjet që u diskutuan, vendimet që u morën si dhe forma dhe rezultati i votimeve.
2. Procesverbali mbahet nga Sekretari dhe i dërgohet për miratim të gjithë anëtarëve që kanë marrë pjesë në mbledhje. Nëse nuk ka kundërshtime nga anëtarët, atëherë

procesverbali i mbledhjes zbardhet dhe nënshkruhet nga Kryetari dhe të gjithë anëtarët pjesëmarrës në mbledhje në fillim të mbledhjes pasardhëse.

3. Në rastet kur mbledhja është zhvilluar gjatë një periudhe më shumë se një ditore, atëherë procesverbali paraqet në formë të përmbledhur diskutimet e zhvilluara gjatë secilës ditë.
4. Anëtarët e Këshillit mund të kërkojnë që në procesverbal të shënohen arsyet e vendimit kundër vendimit të miratuar.

Neni 14 - Zbardhja e vendimeve

1. Vendimet e Këshillit zbardhen brenda 3 (tri) ditëve nga data e mbledhjes dhe, dy kopje të tij nënshkruhen nga Kryetari dhe Sekretariati. Kopja e tretë nënshkruhet nga të gjithë anëtarët pjesëmarrës në mbledhje dhe depozitohet në protokollin e INSTAT.
2. Në rastin kur materiali i marrë në shqyrtim nuk miratohet, atëherë vendimi për mosmiratimin përmban edhe argumentimin përkatës të Këshillit.
3. Vendimet e miratuara nxirren dhe qarkullojnë nga zyra e Protokoll-Arkivës së INSTAT-it vetëm me nënshkrimin e kryetarit.
4. Drejtori i Përgjithshëm i INSTAT merr masa për zbatimin e vendimeve përkatëse të Këshillit.
5. Vendimet e Këshillit botohen në faqen zyrtare elektronike të INSTAT-it.

Neni 15 - Angazhimi i ekspertëve të jashtëm për një fushë të caktuar të statistikave zyrtare dhe raporti i ekspertëve

1. Në rastin kur një anëtar e gjykon të nevojshme për të kërkuar vlerësim, llogaritje ose kontroll të pavarur nga ekspertë të jashtëm për një fushë të caktuar të statistikave zyrtare, ai depoziton pranë Këshillit një kërkesë të argumentuar, duke iu referuar parimeve të statistikave zyrtare dhe cilësisë statistikore.
2. Këshilli merr në shqyrtim kërkesën e paraqitur në mbledhjen e radhës. Pas procedurës së votimit dhe marrjes së vendimit sipas përcaktimeve të nenin 12 të kësaj rregulloreje, Kryetari i Këshillit të Statistikave i drejtohet me kërkesë INSTAT për fillimin e procedurave të prokurimit për përzgjedhjen e ekspertit/ëve të jashtëm.

3. Anëtari që ka paraqitur kërkesën për gatit Termat e Referencës për përzgjedhjen e ekspertit/ëve. Termat e Referencës duhet të përmbajnë dhe kërkesën për përgatitjen nga eksperti/ët të një raporti mbi objektin dhe gjetjet e ekspertizës si dhe metodologjinë e ndjekur për ekspertimin. Raporti përfundimtar i paraqitet për shqyrtim Këshillit.
4. Kryetari i Këshillit ia paraqet raportin anëtarëve brenda 5 ditëve nga dorëzimi dhe diskuton përmbajtjen në mbledhjen e radhës. Këshilli merr në shqyrtim raportin e paraqitur dhe, nëse vendos, i transmeton zyrtarisht INSTAT-it rekomandimet e dala nga raporti ekspertit/ëve.
5. Formati i kërkesës për ekspertin/ët e jashtëm drejtuar INSTAT duhet të jetë sipas modelit të shtojcës nr. 1 bashkëlidhur kësaj rregullore.
6. Për rastet e parashikuara në këtë nen, Drejtori i Përgjithshëm i INSTAT merr pjesë në mbledhjet e Këshillit pa të drejtë vote.

IV - KOMUNIKIMI ZYRTAR

Neni 16 - Procedura e komunikimit me stafin e agjencive statistikore

1. Në rastin kur anëtari i Këshillit të Statistikave e gjykon të nevojshme për të komunikuar me stafin e agjencive statistikore, ai depoziton pranë Kryetarit një kërkesë në të cilën justifikon nevojën e komunikimit me agjencinë statistikore përkatëse dhe qëllimin që kërkon të realizojë nëpërmjet këtij komunikimi. Formati i kërkesës duhet të jetë sipas modelit të shtojcës nr. 2 bashkëlidhur kësaj rregullore.
2. Nëse gjykohet e justifikuar nga Këshilli i Statistikave, atëherë kryetari i Këshillit pajis anëtarin me një autorizim për të vepruar në emër të Këshillit të Statistikave. Formati i autorizimit duhet të jetë sipas modelit të shtojcës nr. 3 bashkëlidhur kësaj rregullore.
3. Komunikimi me stafin e agjencive statistikore duhet të zhvillohet vetëm për qëllimet e detyrave të Këshillit të Statistikave të përcaktuara në Ligjin nr. 17/2018 "Për statistikat zyrtare".

Neni 17 - Formati i shkresës

1. Formati i shkresës zyrtare të Këshillit duhet të jetë në përputhje me VKM nr. 4, datë 19.6.2017 "Për miratimin e rregullores së njësuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të Republikës së Shqipërisë".

2. Ngarkohet Sekretariati i Këshillit të kujdeset për respektimin e formatit të shkresave të nxjerra nga Këshilli.
3. Shkresa zyrtare e Këshillit të Statistikave nënshkruhet nga Kryetari.

V - Konfidencialiteti dhe konflikti i interesave

Neni 18 - Konfidencialiteti dhe konflikti i interesave

1. Çdo anëtar i Këshillit është i detyruar të ruajë konfidencialitetin e të dhënave statistikore si dhe çdo informacioni tjetër sensitiv për të cilat vihet në dijeni gjatë ushtrimit të funksionit të tij, sipas ligjit nr. 17/ 2018 "Për Statistikat Zyrtare".
2. Anëtari i Këshillit, i cili gjendet në konflikt interesi, sipas Ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", i ndryshuar, ndërmjet detyrës publike dhe interesave private të tij, të drejtpërdrejta ose të tërthorta, të cilat ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave si anëtar i Këshillit, duhet ta deklarojë menjëherë gjendjen e konfliktit si dhe të mënjanohet nga vendimmarrja rast pas rasti.
3. Deklarimi i Kryetarit ose anëtarëve të Këshillit për gjendjen e konfliktit të interesave, sipas pikës 2 të këtij neni, i paraqitet Këshillit dhe Inspektoratit të Lartë për Deklarimin e Pasurive dhe Konfliktit të Interesave jo më vonë se 10 ditë nga vënia në dijeni e këtij konflikti.

VI - TË TJERA

Neni 19 - Dispozita të fundit

1. Çdo dokumentacion që ka të bëjë me veprimtarinë e Këshillit të Statistikave mbahet në një rubrikë/regjistër të veçantë për protokollimin nga Zyra e Protokoll-Arkivës të INSTAT.
2. Sekretariati i Këshillit të Statistikave kujdeset për inventarizimin dhe depozitimin pranë arkivës së INSTAT të çdo dokumentacioni, procesverbalit apo vendimi të dalë nga Këshilli i Statistikave në përputhje me kërkesat e Ligjit "Për arkivat" dhe këtë rregullore.

3. Rregullorja e Këshillit të Statistikave miratuar me Vendimin Qarkullues të Këshillit nr. 2 datë 04.01.2018 shfuqizohet.

Kjo rregullore hyn në fuqi në datën e miratimit nga Këshilli i Statistikave.

U miratua sot më datë ____ . ____ 2019

Kryetari i Këshillit të Statistikave

Sekretariati

Shtojca 1



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I STATISTIKAVE

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____, 2019

Lënda: (Shënohet shkurtimi përmbajtësor i dokumentit)

INSTITUTIT TË STATISTIKAVE

Adresa: Rr. "Vllazën Huta" Nr. 35, H. 1, Njësia Administrative Nr. 2, 1017 Tiranë.

Për dijeni: (në rastet kur janë institucione të tjera për dijeni shënohet emërtesa dhe vendi ku ka selinë institucioni, njësoj si më sipër)

Në vijim/ Në përgjigje suajës/ tonës me Nr. ____ datë ____ . ____ . ____ .

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

KRYETARI

Rr. "Vllazën Huta" Nr. 35, H. 1, Njësia Administrative Nr. 2, 1017 Tiranë, Shqipëri

Shtojca 2



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I STATISTIKAVE

Tiranë, më ____ . ____ . 2019

Lënda: (Shënohet shkurtimi përmbajtësor i dokumentit)

Drejtuar: KRYETARIT TË KËSHILLIT TË STATISTIKAVE

I nderuar Z. Kryetar,

Në vijim/ Në përgjigje suajës/ tonës me Nr. ____ datë ____ . ____ . ____ .

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

ANËTAR

Shtojca 3



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I STATISTIKAVE

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____, 2019

AUTORIZIM

Autorizohet Z./Znj. _____ të kërkojë në emër të Këshillit të Statistikave informacionin në lidhje me _____ pranë _____ për qëllime _____.

KRYETARI